KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**MONTHLY NEWSLETTER**
OCTOBER 6th, 2023

# UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

**October 7-11** | **ANUGA Köln**
**October 11-12** | **9th BME Purchasing Initiative Western Balkans**
**October 18-20** | **58. Sympozium Einkauf und Logistik**
**October 25-26** | **Supplier Balkan Expo-SUBEX Skopje**

## Director's Note

**Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,**

Muajin që kemi lënë pas, angazhimi i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe ekipit të saj ka qenë në disa drejtime.

Po ndajmë me ju një përmbledhje të ngjarjeve të rëndësishme që lidhen me zhvillimet ekonomike që afektojnë në punët e bizneseve:

**Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

In the month that we left behind, the commitment of the German-Kosovar Business Association and its team has been in several directions.

We are sharing with you a summary of important events related to economic developments that affect business´ operations:

### Business After Hours

Gjatë kësaj jave u mbajt ngjarja Business After Hours, e mbështetur nga kompania anëtare **RailTrans**.

Kompanitë pjesëmarrëse patën rastin të diskutojnë dhe të rrjetëzohen me njëri tjetrin, si dhe të mësojnë nga eksperienca e ekspertit të Senior Expert Service, z. Paul Herbert Tschorn, i cili është i angazhuar te kompania anëtare Sierra Lab.

Nëse dëshironi të mbështesni Business After Hours të radhës, apo edhe eventet e ardhshme të OEGJK, ju lutemi të na kontaktoni.

### Business After Hours

During this week, Business After Hours was held, supported by member company **RailTrans**.

Participating companies had the opportunity to discuss and network with each other, as well as learn from the experience of the Senior Expert Service expert, Mr. Paul Herbert Tschorn, who is employed by member company Sierra Lab.

If you are interesting in supporting the next Business After Hours or the upcoming events of KDWV, please contact us.





**Zilonis Energy Solutions GmbH hapi degën e saj në Kosovë**

Kompania ZILONIS, e këshilluar për hapje të degës në Kosovë nga OEGJK, mbajti ceremoninë e hapjes së degës së saj në Kosovë këtë javë.

ZILONIS, kompani me focus në zgjidhjet e qëndrueshme për këmbyesit e nxehtësisë, po zgjeron aktivitetin me inovacione dhe qëndrueshmëri në rajonin e Evropës Juglindore.

Drejtoresha ekzekutive, znj. Nora Hasani, në ceremoninë e hapjes mbajti një fjalë rasti.

**Zilonis Energy Solutions GmbH opened its branch in Kosovo**

The company ZILONIS, advised on the opening of their branch in Kosovo by KDWV, held the opening ceremony of its branch in Kosovo, this week.

ZILONIS, a company with a focus on sustainable solutions for heat exchangers, is expanding its activity with innovations and sustainability in the region of Southeast Europe.

Executive director, Ms. Nora Hasani delivered a speech at the opening ceremony.

**U mbajt Panairi më i madh në Evropë për teknologji informative, marketing dhe media, DMEXCO 2023**

DMEXCO është ngjarja kryesore e marketingut dhe teknologjisë digjitale në Evropë, si vendi i takimit dhe komunitet për akterët kyç në biznesin digjital, marketingun dhe inovacionin.

**The largest Fair in Europe for information technology, marketing and media, DMEXCO 2023, was held in Cologne**

DMEXCO is Europe's leading digital marketing and technology event, as the meeting place and community for key players in digital business, marketing and innovation.

Ngjarja u mbajt me datat 20-21 Shtator 2023 në Köln të Gjermanisë, dhe Kosova u përfaqësua nga 12 kompani, mes të cilave u gjendën dhe kompani anëtare të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare: Koperativa dhe MetDaan.

Për të qenë pranë anëtarëve tanë, e pranishme në DMEXCO nga stafi ynë ishte edhe Eriola Muhaxhiri.

Shtandi i Kosovës u vizitua nga Konsullja e Kosovës në Dusseldorf, znj. Mirsada Voca e cila u takua gjithashtu me Eriola Muhaxhirin, ku u bisedua për të intensifikuar bashkëpunimin me konsullatën që të ketë një lidhje direkte me biznese.

Pjesëmarrja e kompanive në këtë panair është mundësuar nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), që vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

The event was held on September 20-21, 2023 in Köln, Germany, and Kosovo was represented by 12 companies, among which were member companies of the German-Kosovar Business Association: Koperativa and MetDaan.

To be close to our members, our staff member Eriola Muhaxhiri was also present at DMEXCO.

The Kosovo stand was visited by the Kosovo Consul in Dusseldorf, Ms. Mirsada Voca who also met with Eriola Muhaxhiri, where they talked about intensifying cooperation with the consulate to have a direct connection with the businesses.

The participation of companies in this fair was made possible by the Agency for Investments and Enterprise Support in Kosovo (KIESA), which functions within the Ministry of Industry, Enterprise and Trade.






KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**MONTHLY NEWSLETTER**
OCTOBER 6th, 2023






## OEGJK dhe ITP bëhen bashkë për tërheqjen e bizneseve gjermane në Kosovë

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren (ITP) kanë filluar të intensifikojnë përpjekjet e përbashkëta në tërheqjen e bizneseve gjermane në vend dhe të lehtësojnë promovimin e eksportit për kompanitë vendore përmes ofrimit të shërbimeve të ndërsjella, përkatësisht:

Shërbimi Soft-Landing, që synon të tërheqë bizneset gjermane në ITP dhe të lehtësojë integrimin e tyre, dhe

Shërbimi Go-Global, i cili mundëson eksportimin e bizneseve anëtare të ITP në Gjermani.

Marrëveshja u nënshkrua nga drejtoresha e OEGJK-së, znj. Nora Hasani dhe përfaqësuesi i autorizuar i ITP Prizren, z. Muhamed Rexhepi.

Më tej, u bë e ditur që bashkëpunimi ndërmjet OEGJK dhe ITP do të marrë në konsideratë aktivitetet e përbashkëta promovuese për hulumtimin, komercializimin dhe ndërmarrësinë, pjesëmarrjen në programe dhe projekte vendore e ndërkombëtare në inovacion, teknologji, ndërmarrësi, hulumtim dhe zhvillim, shkëmbimin e njohurive, ekspertizën, mentorimin dhe trajnimet

## KDWV and ITP Join Forces to Attract German Businesses to Kosovo

The German-Kosovar Business Association and Innovation and Training Park in Prizren (ITP) have started to intensify joint efforts in attracting German businesses to the country and facilitate export promotion for local companies through the provision of mutual services, namely:

The Soft-Landing Service, aims to attract German businesses to ITP and facilitate their integration, and

The Go-Global Service, which enables the export of ITP member businesses to Germany.

This agreement was formally signed by the executive director of KDWV, Ms. Nora Hasani and the authorized representative of ITP, Mr. Muhamed Rexhepi.

Furthermore, it was announced that the collaboration between KDWV and ITP will encompass joint promotional activities for research, commercialization, and entrepreneurship, as well as participation in local and international programs and projects related to innovation, technology, entrepreneurship, research, and development. The partnership will also facilitate the exchange of knowledge, expertise, mentoring, professional training of staff, and the sharing of best practices.

profesionale të stafit dhe ndarjes së praktikave të mira.

**Fotografi nga nënshkrimi i marrëveshjes**

Znj. Nora Hasani dhe z. Muhamed Rexhepi pas nënshkrimit të marrëveshjes

**Photo from the signing of the agreement**

Ms. Nora Hasani and Mr. Muhamed Rexhepi after the singing the agreement



**Presidentja e Bordit dhe drejtoresha e OEGJK-së në Regional Business Forum "The Western Balkans in 2030 and beyond"**

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare u përfaqësua me Presidenten e Bordit të OEGJK-së, znj. Eriola Bibolli dhe drejtoreshën znj. Nora Hasani në Forumin Ekonomik Rajonal "The Western Balkans in 2030 and beyond" që është mbajtur përgjatë datave 13 dhe 14 shtatorit.

**President of the Board and Director of KDWV at the Regional Business Forum "The Western Balkans in 2030 and later"**

The German-Kosovar Business Association was represented by the President of the Board, Ms. Eriola Bibolli and the director of KDWV Ms. Nora Hasani at the Regional Economic Forum "The Western Balkans in 2030 and beyond" that was held on September 13 and 14.

Ky forum ishte një vend takim për të diskutuar shumë tema me përfaqësues nga biznesi, politika dhe shoqëria civile, ku ndër të tjera u diskutua dhe për prespektivën e rajonit deri më 2030.

Në ditën e dytë të forumit u mbajt paneli i diskutimit me temën “Ndikimi i gjeopolitikës në vendet e Ballkanit Perëndimor - Ndikimi i luftës së Rusisë në Ukrainë dhe roli i palëve tjera gjeopolitike”.

Këtë panel e ka moderuar drejtoresha e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, znj. Nora Hasani, teksa panelistë ishin znj. Dragana Djurica nga European Movement Serbia dhe z. Thomas Narbeshuber nga BASF.

Forumi Ekonomik Rajonal “The Western Balkans in 2030 and beyond” është organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano-Serbe dhe Komiteti Lindor i Ekonomisë Gjermane.

This forum was a meeting place to discuss many topics with representatives from business, politics and civil society, among which topics was discussions for the region perspective until 2030.

On the second day of the forum, a discussion panel was held on the topic "The impact of geopolitics on the countries of the Western Balkans - The impact of Russia's war on Ukraine and the role of other geopolitical stakeholders".

The panel was moderated by the director of the German-Kosovar Business Association, Ms. Nora Hasani, while the panelists were, Ms. Dragana Djurica from European Movement Serbia and Mr. Thomas Narbeshuber from BASF.

The Regional Economic Forum "The Western Balkans in 2030 and beyond" was organized by the German-Serbian Chamber of Commerce and the Eastern Committee of the German Economy.

**Fotografi nga Forumi Ekonomik Rajonal “The Western Balkans in 2030 and beyond”**

**1.** Znj. Eriola Bibolli dhe znj. Nora Hasani
**2.** Znj. Nora Hasani gjatë moderimit të panelit

**Photos from the Regional Economic Forum "The Western Balkans in 2030 and beyond"**

**1.** Ms. Eriola Bibolli and Ms. Nora Hasani
**2.** Ms. Nora Hasani during panel moderation






## Drejtoresha e OEGJK-së takoi Guvernatorin e ri të BQK-së, Ahmet Ismailin

Drejtoresha e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, znj. Nora Hasani është takuar me Guvernatorin e ri të Bankës Qendrore të Kosovës, z. Ahmeti Ismaili.

Gjatë këtij takimi u diskutua për mbështetjen reciproke mes BQK-së dhe OEGJK-së, në përmirësimin e kornizës ligjore, mundësitë për rritjen e investimeve të huaja, rritjen e qasjes në shërbimet financiare dhe çështje tjera që lidhen me objektivat e BQK-së.

Bashkëpunimi mes OEGJK-së dhe BQK-së për të arritur një zhvillim ekonomik më të madh të Kosovës ishte dakordimi bazë i takimit.

## The director of KDWV met the new Governor of Central Bank of Kosovo, Ahmet Ismaili

Director of the German-Kosovar Business Association, Ms. Nora Hasani met with the new Governor of the Central Bank of Kosovo, Mr. Ahmeti Ismaili.

During this meeting, mutual support between the CBK and KDWV was discussed in improving the legal framework, opportunities for increasing foreign investments, increasing access to financial services and other issues related to the objectives of the CBK.

The cooperation between KDWV and CBK to achieve greater economic development of Kosovo was the basic agreement of the meeting.

## Takimet e Klasterëve të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare

Gjatë muajit Shtator u mbajtën takimet e 5 klasterëve të OEGJK për: ICT, E-Commerce, Energji e Ripërtëritshme, Tatime dhe Taksa, dhe Edukim Profesional.

Përgjatë këtyre takimeve u diskutua për planin e punës në muajt e mbetur të këtij viti, si dhe për objektivat e vitit 2024.

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare do të vazhdojë të ngrisë zërin në emër të anëtarve për të avokuar te institucionet lokale dhe qendrore për të rregulluar ambientin e të bërit biznes.

## Clusters meetings of the German-Kosovar Business Association

During September, were held the meetings of 5 clusters of KDWV of: ICT, E-Commerce, Renewable Energy, Taxes and Tarifs, and Professional Education.

During these meetings, it was discussed the work plan for the remaining months of this year, as well as the objectives for 2024.

The German-Kosovar Business Association will continue to raise its voice on behalf of its members to advocate to local and central institutions to regulate the business environment.













**ATK plotëson/ndryshon procedurat e pajisjes me Vërtetim Tatimor**

Administrata Tatimore e Kosovës, ka njoftuar se ka nxjerrë udhëzuesin me të cilin plotëson/ndryshon procedurat e pajisjes me Vërtetim Tatimor.

Për më shumë detaje, klikoni ketu.

**TAK amends/ supplements the procedures for obtaining Tax Certificate**

The Tax Administration of Kosovo hereby informs you has issued the Guideline that amends/supplements the procedures for obtaining Tax Certificate.

For more details, click here.

KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**MONTHLY NEWSLETTER**
OCTOBER 6th, 2023

## ATK plotëson/ndryshon Procedurat e Rimbursimit

Administrata Tatimore e Kosovës ka plotësuar/ndryshuar tashmë Procedurat e Rimbursimit.

Për më shumë detaje, klikoni ketu.

## TAK has supplements/amends the Reimbursement Procedures

Tax Administration of Kosovo, now has supplements/amends the Reimbursement Procedures

For more details, click here.

## 10,000 të rinjëve u mundësohet punë praktike në dy vite përmes KGenU

Në ambientet e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare është mbajtur sesioni informues rreth Kosovo Generation Unlimited (KGenU), ku u prezantua programi i këtij projekti.

KGenU është një projekt/platformë për të rinjtë dhe kompanitë pritëse, e cila implementohet në partneritet dhe nën udhëheqjen e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, UNICEF-it dhe Rrjetit CSR Kosova.

Për më shumë detaje, klikoni këtu.

## 10,000 youth practical jobs in two years through KGenU

An information session about Kosovo Generation Unlimited (KGenU) was held in the premises of the German-Kosovar Business Association, where the program of this project was presented.

KGenU is a project/platform for young people and host companies, which is implemented in partnership and under the leadership of the Ministry of Finance, Labor and Transfers, UNICEF and CSR Kosovo Network.

For more details, click here.

KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**MONTHLY NEWSLETTER**
OCTOBER 6th, 2023

## YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV

**BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:**
ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina
Monday – Friday | 8.30 – 16.30



**Greta Kazia**

HR, Përgjegjëse për Financa dhe Anëtarësi

HR, Responsible for Finance and Membership

greta.kazia@oegjk.org



**Besarta Hyseni**

Udhëheqëse e Departamentit mbështetje dhe shërbime të anëtarëve
Këshilltare për Arsim Profesional Dual

Head of Market Entry & Events
Advisor for VET
besarta.hyseni@oegjk.org



**Elena Elshani**

Asistente Ekzekutive
Përfaqësuese për Shërbimin e Ekspertëve Seniorë (SES)

Executive Assistant
Senior Expert Service Representative (SES)

elena.elshani@oegjk.org



**Gonxhe Abazi**

Zyrtare për Këshillim Ligjor

Legal Officer

gonxhe.abazi@oegjk.org



**Eriola Muhaxhiri**

Koordinatore / Coordinator

eriola.muhaxhiri@oegjk.org